

VENDIM
Nr. 25, datë 20.5.2016

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 18, DATË 12.5.2015, “PËR LICENCIM SH.
A UJËSJELLËS-KANALIZIME KUKËS”**

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

Në vendimin nr. 18, datë 12.5.2015, “Për licencim sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Kukës” bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 bëhet ndryshimi si më poshtë:

Drejtues ligjor: Gëzim Shehu.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ndriçim Shani